



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 250, Datë 16.08.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB SUN ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1892/7 prot., datë 11.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “ALB SUN ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Bashkinë Fier”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ALB SUN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892 prot., datë 07.07.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 19.07.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALB SUN ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkinë Fier.
- ERE botoi njoftimin për fillimin e kësaj procedure në median e shkruar (në datat 20.07.2023 dhe 21.07.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.07.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892/2 prot., datë 18.07.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi. Në vijim të shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën nr. 1893/4 prot., datë 28.07.2023, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 229/2023 dhe i evidentoi dokumentacionin që mbetej ende për t’u plotësuar nga ky aplikim.

- Po ashtu, me shkresën nr. 1893/5 prot., datë 28.07.2023, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALB SUN ENERGY” sh.p.k.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1893/6, datë 03.08.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ALB SUN ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se, nga sa deklaruar nga shoqëria, rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ALB SUN ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ALB SUN ENERGY” sh.p.k., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI